



Datë: 29.10.2025
Numër Protokolli: 7033/2025

A.nr.1324/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, më Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.1324/2025, të datës 09.07.2025, të parashtruar nga ankuesi P.T, kundër organit të punësimit: Komunës së Pejës, në çështjen juridike “*shkelje e të drejtës në pagë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.4 dhe 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 29.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

I.Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.1324/2025, e datës 09.07.2025, e parashtruar nga ankuesi P.T.

Obligohet Kryetari i Komunës së Pejës që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshëm ligjore-administrative në mënyrë që në afat sa me të arsyeshëm kohor të përfundohet procesi për miratimin e rregullores për sistematizimin vendeve të punës për nëpunësit civilë në këtë institucion, që të gjitha veprime këto të iniciohen brenda fatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesi P.T (*tutje referuar vetëm ankuesja*), më datë 09.07.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Përgjigjes në kërkesë të datës 25.06.2025 të Zyrës së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Pejës, për shkak të mos lëshimit të akt Emërimit, sipas klasës së pagës 4.9, profesional 2, të paraparë më Katalogun e Vendeve të punës për shërbimin Civil dhe mos realizimin të pagës në përputhje me klasën e pagës 4.9, të paraparë më katalogun e Vendeve të punës për Shërbimin Civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 14.07.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Pejës, ndërsa kjo e fundit më datë 18.07.2025 ka përcjellë fare përgjigje në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 4589/2025, të datës 09.07.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Diplomën e datës 31.05.2001; Akt Emërimit e darës 04.01.2012; Certifikatën me Nr. 03/17; Përgjigjen në kërkesë të datës 25.06.2025 nga NJBNJ e Komunës së Pejës; Kopjen e ID-së së ankuesit; Pagesën për periudhë qershor

2025; ,Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 17.07.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 18.07.2025; Kërkesën e datës 27.05.2025 të ankuesit.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe referuar pretendimeve ankimore të parashtruar nga ankuesi, ka gjetur se ankesa **është e parakohshme**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesi sipas Akt Emërimit me Nr.01-112-67 të datës 04.01.2012, është i punësuar në pozitën e punës Zyrtar i Z.K.GJ.C, në Drejtorinë e Administratës në Komunë e Pejës.

Më datë 27.05.2025, ankuesi i është drejtuar organit të punësimit me kërkesë për ndryshimin e Akt Emërimit, përkatësisht koeficientit nga profesional 3 në profesion 2 sipas katalogut të vendeve të punës në shërbimin civil, ndërsa u.d i Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore i Komunës së Pejës më datë 25.06.2025, i përmes përgjigjes në kërkesë, ka njoftuar ankuesin: *Me Vendimin e Kryetarit të Komunës së Pejës është formuar grupi punues për hartimin e Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, është përgatitur drafti final, jemi në fazën e dëgjimit publik dhe më pas miratimin në Kuvendin Komunal, andaj, me miratimin e rregullores përkatëse Zyrtare e ZKGJC-ve që kanë kualifikim universitar (së paku bachelor) do të kenë koeficient si profesional 2.*

Ankuesi pas pranimit të përgjigjes nga organi i punësimit ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave ligjore, verifikimit të gabuar të gjendjes faktike si dhe zbatimi i gabuar të së drejtës materiale, mbi pretendimin ankimor se institucioni punëdhënës nuk ka zbatuar Vendimin Nr.08/226 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 23.10.2024. Shton se duhet të kategorizohet në klasën profesional 2, me koeficient 4.9, por ajo ende realizon pagë sipas klasës profesionale 3 më koeficient 4.46. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën dhe të detyroj organin përkatës të punësimit, respektivisht Komunën e Pejës që të bëj ndryshim-plotësimin e akt emërimit, ashtu që pozita e saj të klasifikohet sipas klasës profesional 2, me koeficient të pagës 4.9, të paraparë me Katalogun e Vendeve të Punës, si dhe të bëj kompensimin e diferencës në mënyrë retroaktive, nga data e hyrjes në fuqi e katalogut.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, me theks të veçantë nenin 2 paragrafi 1 dhe 2 si dhe nenin 14 paragrafi 3 ku parashihet se: ” **Neni 2:** 1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj”, **Neni 14:** 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik...”, referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa, klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe rregulloren e aplikueshme për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil.

Në fakt, Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi i provave të lëndës ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Komuna e Pejës deri në parashtrimin e ankesës nga ana e ankuesit nuk ka të përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, mirëpo, në përgjigjen në ankesë të datës 25.06.2025 si dhe shkresave tjera të çështjes del së Komuna e Pejës

ka ndërmarr veprime në kuptim të nxjerrjes së Rregullores për organizim të brendshëm dhe klasifikim të vendeve të punës në këtë institucion, gjegjësisht, më datë 13.01.2025, ka nxjerrë vendimin për themelimin grupit punues përgjegjës për hartimin e draft rregullores në fjalë, është hartuar drafti i parë i cili është përcjella pranë DMZP-së për komente dhe mendim dhe pas disa vërejtjeve nga ky i fundit është përgatit drafti final i rregullores i cili është në fazën e dëgjimit publik. Andaj, mbi ketë rrethanë faktike, konkretisht duke qenë se organi përkatës i punësimit është në fazën e përgatitjes së rregullores për organizim të brendshëm dhe klasifikim të pozitave të punës për nëpunësit e saj publikë, akt nënligjor që bartë edhe obligime tjera buxhetore, atëherë, Kolegji i Këshillit vlerëson se ankesa e parashtruar nga ankuesi për klasifikimin e pozitës së tij sipas kategorisë profesionale 2, është e parakohshme, dhe si e tillë, në këtë fazë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritore.

Në kuptim të parimit të ligjshmërisë dhe pritshmërisë legjitime si parime bazë në punën e institucioneve publike, Kolegji i Këshillit rikujton organin punëdhënës në këtë rast Komunën e Pejës që bazuar në nenin 34 të Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, e aplikueshme nga data 28.02.2024, si dhe në mbështetje të Vendimit Nr.08/226, të datës 23.10.2024, të Qeverisë së Republikës së Kosovës për miratimin e Katalogut të Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, **ka qenë e obliguar që të përfundoj klasifikimin e vendeve të punës në përputhje me Rregulloren Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës dhe këtë katalog.** Andaj, çdo shmangie nga ky detyrim ligjor përbën mos veprim të organit publik dhe njëkohësisht bartë pasoja materiale për zyrtarët publikë në kuptim të klasifikimit të pozitës dhe pagës së tyre, kështu që, Komuna e Pejës duhet të përfundoj sa më shpejt rregulloren për organizim të brendshëm dhe sistematizimin vendeve të punës, në atë mënyrë që nëpunësit të realizojnë pagën në pajtim me legjislacionin aplikueshëm për pagat në sektorin publik.

Thënë si më lartë, e në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1342/2025

Avdyl Bekteshi

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj - Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, P.T;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Pejës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së